

## Emocionet e një udhëtimi në Vendet e Shenjta të Islamit

*Nga hoxhë Sokol Kondakçiu*

Në jetën e një besimtari ka disa momente të cilat janë të papërsëritshme dhe të pakonvertueshme në një vlerë të caktuar. Ato janë momentet ku ndoshta nëpërmjet një telefonate mund të informohesh, se ke fatin të bëhesh vizitor i Qabes së Madhnueshme, duke mos e planifikuar këtë gjë. Kushdo nga ne do t'i përgjigjej me një po, nëse kjo dhuratë do të na vinte në formën e një pyetje se: a dëshiron të shkosh në umra?

Pas kësaj besimtari mendon, se kjo umra është një dhuratë e madhe, të cilën Allahu i Madhëruar ia ka dhënë atij dhe është një privilegj për atë gjithashtu, ndërkohë që shumë dëshirojnë të jenë të tillë, por mundësitë dhe kushtet nuk ua lejojnë.

Prej këtu nisim dhe vërshojnë mendimet. Padyshim që një musliman i mirë duhet të mendojë se çdo gjë që ndodh në këtë botë ndodh me lejen e Allahut të Madhëruar dhe se çdo gjë ka kuptimin dhe urtësinë e vet.

Mendimet vërshojnë, ndoshta ka ardhur koha për ta ndryshuar mënyrën e jetesës, ndoshta ka ardhur momenti dhe rasti për të plotësuar mangësitë me sevape nëpërmjet umres, me namaze, lutje dhe tavaf në Qabe. Kjo ndoshta mund të jetë një mundësi që të jepet ty për të ndryshuar dhe kjo nga mirësia e Zotit tënd për ty. Ndoshta mund të jetë kjo dhe mundësia jote e fundit dhe Zoti yt dëshiron të të lehtësojë e të nderojë para takimit me të. I Dërguari i Allahut thotë për vizitën e Qabes:

“Nga Umra në Umre fshihen gjynahet mes tyre...” Buhari dhe Muslimi. Megjithatë momentet e gëzuara fillojnë që kur e merr lajmin e më pas bëhesh gati për një udhëtim të tillë, i cili është një udhëtim i lartësimit të shpirtit dhe i përsosjes së qenies tonë. Stacioni i parë i këtij udhëtimi ishte nisja me avion. Në sytë e vëllezërve të tjere shihej një gezim i pafshehur po ashtu dhe në fjalët e tyre, e si të mos ishim të atillë ne ishim nisur për umra.

Një stacion i rëndësishëm në këtë udhëtim shpirtëror ishte veshja e ihramit të bardhë dhe zhveshja nga rrobat e përditshmërisë, dhe në këtë moment e sheh atë që pak më parë të dukej si ëndërr, se ti po i afrosh shumë drejt destinacionit, dhe kupton se ëndërra po bëhet realitet. Në këto momente jo vetëm ti, por edhe ata që të shohin, të shohin me një zili nga malli dhe dëshira që kanë për të shkuar në Qabe, me ihramin e bardhë të gjithë duke qëndruar në një vend të grumbulluar. Në një nga aeroportet e Turqisë ne dukeshim si ata pëlumbat e bardhë të paqes, që donim vetëm të shtegtonim në Vendet e Shenjta, dhe aty ku gjen burimin e paqes dhe të mirësisë. Disa shikonin me habi, ngase jeta e kësaj



bote është aq e vrrullshme dhe aq e rrëmbyeshme, saqë të merr me vete dhe të bën të harrosh deri në momentin kur e sheh një pamje të tillë dhe ndoshta mendon thellë në brendinë e tij dhe me një shikim dëshpëruar sikur po të thotë: “Një ditë edhe unë do të kthehem”.

Një nga stacionet e këtij udhëtimi është stacioni i destinacionit, ku një udhëtar me padurim dëshiron të jetë përballë shtëpisë së Allahut, pikërisht në Qaben e Madhnueshme e ta përshëndesë atë, të bëjë tavafin me shtatë rrotullimet rreth tij, duke u lutur e duke u përmalluar me të. Këto emocione bëhen ende më të forta, kur mendon se pikërisht këtu vetë i Dërguari i Allahut ka lindur dhe është rritur është bërë profet dhe prej këtu ka nisur të bëjë thirrje në rrugë të Allahut. Në momente të tilla sjell ndërmend historinë e profetit Muhamed a.s. me të gjitha gëzimet, hidhërimet, dhe me vuajtjet e Tij, dhe të duket se edhe ti je një copëz e vogël brenda kësaj historie.

Falja e dy rekateve në Mekamin e Ibrahimit aty ku profeti Ibrahim fali namaz pas përfundimit të rindërtimit të Qabes së Madhnueshme dhe u lut për pasardhësit e tij, që ata t'i bëjnë një umet të madhe e të përkushtuar. Në këto momente emocionuese mes besimit, përkushtimit dhe përmallimit, mendja të shkon tek vetja, duke i thënë: Elhamdulillah,... unë jam prej umetit të Muhamedit a.s., unë jam përfshirë në lutjen e profetit Ibrahim a.s.

Pas kësaj pirja e ujit të Zemzemit ndaj të cilit kishim etje trupore dhe shpirtërore na kujton mrekullinë e Allahut në historikun e këtij burimi. Ajo që të shkon ndërmend në këto momente është, se duhet të kalojmë një provë, e ajo është pirja e sa më shumë ujë deri sa të fryhesh, ashtu si ka vepruar vetë Profeti a.s., sepse munafikët nuk mund ta bëjnë një gjë të tillë. Me këtë pirje shuhet etja trupore dhe pjesërisht ajo shpirtërore nisur me një bismilah dhe përfunduar me elhamdulillah për këtë mirësi.

Saji, xhirot mes Safasë dhe Mervesë janë një tjetër stacion, ku na kujtohet Haxhireja

me fëmijën e saj, Ismailin. Aty kupton se sa të lodhshme janë ato xhiro, por po ashtu kupton se një mundim të tillë nuk do ta bëje për diçka tjetër. Në lidhje me këtë me kujtohen diskutimet mes vëllezërve, se kjo me të vërtetë ishte e mundimshme, sidomos në temperatura të larta, dhe pas një lodhje nga udhëtimi pa pushim. Dikush me thoshte, se një mundim të tillë nuk do ta bëja në asnjë vend tjetër, por këtu e bëj me një dëshirë dhe vullnet të madh dhe për këtë falënderimi i takon Allahut, që na bëri besimtarë muslimanë.

Nëse mendojmë se kjo ishte në ndjekje të asaj që bëri Haxhireja, si mundim për të gjetur ujë për fëmijën e saj, atëherë e gjithë jeta është mundim dhe përpjekje për të jetuar e për të qenë kërkues dhe ambicioz për të arritur tek më e mira, dhe kjo nuk arrihet vetëm me përpjekje të vazhdueshme, por edhe me një mbështetje të fortë tek Krijuesi dhe Furnizuesi.

Një nga stacionet emocionuese të këtij udhëtimi ishte edhe mbërritja në Medinen e Profetit Muhamed a.s. Pikërisht aty ku profeti ynë u përkrah nga ensarët dhe aty ku fitoi betejat më vendimtare të Islamit, të cilat nuk ishin qëllim në vetvete. Kjo mirësi duhet të plotësohet me këtë vizitë dhe xhaminë me namazet në të dhe tek Reuda, të cilën Profeti a.s. e ka cilësuar si lulishte të xhenetit. Ky udhëtim nuk mund të ishte

i plotë pa i dhënë salam të zotit të shtëpisë dhe mësuesit të njerezisë, të dashurit tonë Muhamedit a.s. dhe dy shokëve të tij të ngushtë Ebu Bekrit dhe Omerit, Allahu qoftë i kënaqur prej tyre. Me të vërtetë ishin çaste emocionuese të përziera mes mallit dhe besimit, i cili rritet dhe shkon shumë lart, kur je në të tilla kushte dhe rrethana.

Në fund pak pikëllim, i cili vjen nga ndarja. Kur vijnë momentet e ndarjes ato janë vërtetë të trishtueshme dhe mendja menjëherë të shkon tek ajo, se valle a do ta kem përsëri mundësinë për ta vizituar edhe një herë këtë xhami, apo mos kjo është hera e fundit. Kur mendon, se mund të vish përsëri ndarja të bëhet më e lehtë, dhe për këtë e kemi lutur Zotin Tonë, dhe herë pas here të na e mundësojë këtë gjë.

Më në fund si në ëndërr jemi përsëri në avion, por kësaj here në kthim në ndjekje të Perëndimit. Dielli ikte dhe ne i shkonim pas dhe dita bëhej më e gjatë. Dukej sikur ai nuk donte të perëndonte dhe ky në një farë mënyre i ngjan udhëtimin në kohë, por që nuk kursen nga orët tona biologjike të jetës sonë. Nëse ky nuk është një udhëtim real në kohë mund të them, se në një farë mënyre është për ata që Allahu ua ka pranuar Umren, sepse në umra të fshihen gjynahet qysh nga umra e kaluar. Kjo është njësoj sikur të kthehesh prapa në kohë dhe të ndreqesh e të fshish të gjitha gabimet që ke bërë. Kjo është ajo që ndodh me pendimin dhe me punët e mira që kryhen në një adhurim të tillë siç është Umra. Allahu në Kuranin Famëlartë thotë: “Është e vërtetë se punët e mira i fshijnë të këqijat”. Por oferta vazhdon edhe pas kthimit:

“Kush e fal namazin e sabahut me xhemat dhe ulet pas namazit për të bërë dhikrin deri në lindje të diellit e pastal fal dy rekate, ai shpërblehet si të kish bërë Haxhin dhe Umren”.

“Umra nga umra është fshirje për mëkatet që bëhen ndërmjet tyre, ndërsa haxhi i pranuar nuk ka shpërblim tjetër për të vetëm se xheneti.”

Falënderimi i takon Zotit të botëve.

### Fq 4 / Ekonomia Islame - nga parimet në praktikë

*Nga Muhamed Eshref*

### Fq 5 / Ripërtëritja e figurave dhe vlerave të vërteta qytetare

*Nga Bledar KOMINI*

### Fq 7 / Martesa në këndvështrimin Islam

*Nga Xhemal Balla*

# Fetva / Gjikimi fetar për disa çështje që kanë të bëjnë me ruajtjen dhe investimin e vakëfeve

Përgatiti hoxhë Justinian Topulli

## Përkufizimi i vakëfit

Nga ana gjuhësore fjala **uakf** në gjuhën arabe do të thotë: i ndalur, i bllokuar, i palëvizshëm.<sup>1</sup>

Fetarisht vakëfi është: Ruajtja e një pasurie dhe shpenzimi i përfitimeve të saj në rrugë të Allahut.<sup>2</sup>

Argument për këtë është hadithi i autentik, ku i Dërguari i Allahut (paqja qoftë mbi të) i thotë Umer ibn Hatabit për tokën e Hajberit, të cilin ai dëshironte ta jepte sadaka: *"Përdore terrenin e saj si sadaka. Nuk shitet as nuk dhurohet dhe as nuk trashëgohet, por shpenzohen frytet e saj."* Dhe Umeri e dha atë sadaka në rrugë të Allahut, për skllëverit, të varfrit, mikun, udhëtarin...<sup>3</sup> Imam Tirmidhiu pas transmetimit të këtij hadithi thotë: Dijetarët që nga koha e shokëve të Profetit (paqja qoftë mbi të) dhe e të tjerëve që erdhën më pas e marrin si argument bazë këtë hadith. Nuk dimë që të ketë ndonjë mospajtim të parët (e këtij umeti) rreth lejimit të krijimit të vakëfit, qoftë kjo pasuri që lidhet me tokën apo diçka tjetër.<sup>4</sup>

Sipas Ebu Hanifes vakëfi quhet: Ruajtja e një pasurie, në pronësi të atij që e ka kthyer atë në vakëf, dhe dhënia sadaka e përfitimit të nxjerrë prej saj. Ndërsa sipas Ebu Jusufit dhe Muhamed Shejbaniut: Ruajtja e një pasurie në pronësi të Allahut dhe dhënia sadaka e përfitimit të nxjerrë prej saj.<sup>5</sup>

Sipas përcaktimit të Ebu Hanifes vakëfi mund të mos jetë më i tillë, nëse ai që e ka kthyer pronën e tij në vakëf e ndryshon atë, por kjo me dy kushte: që ai të mos ketë kushtëzuar që prona e tij të kthehet në vakëf pas vdekjes së tij, dhe e dyta: të mos të jetë përcaktuar kjo gjë nga kadiu (që të mbetet vakëf), në një rast të tillë lejohet shitja e tij, ndryshe ajo mbetet vakëf.<sup>6</sup>

Ndërsa sipas dy nxënësve të Ebu Hanifes dhe shumicës së nxënësve të tij vakëfi ngelet përherë i tillë edhe nëse pronari i tij i parë ndryshon mendim. Ebu Jusufi thotë për hadithin e mësipërm: Nëse ky hadith do t'i kishte mbërritur Ebu Hanifes ai do të kishte thënë po

të njëjtën gjë.<sup>7</sup> Pra vakëfi konsiderohet vetëm si pronë e Allahut dhe nuk shitet, nuk dhurohet, nuk tjetërohet, nuk trashëgohet dhe as nuk lejohet, që në një mënyrë apo në një tjetër të humbasë rolin e tij si vakëf.<sup>8</sup>

Dijetarët hanefi dhe të tjerë, kanë dhënë fetva se nëse vakëfi shitet kjo shitje është e pavlefshme (batil).<sup>9</sup> Për këtë arsye këta dijetarë kanë përcaktuar, si një nga kushtet kryesore të vakëfit, që ai të mos jetë i përkohshëm, por i përhershëm, e ka përmendur një gjë të tillë pronari i parë i tij ose jo, ai ngelet i përhershëm.<sup>10</sup> Po ashtu një tjetër normë e rëndësishme në ruajtjen e vakëfit është respektimi i destinacionit për të cilin ai është lënë vakëf nga pronari i tij i parë, si për shembull për të varfrit, por me kusht që ky përcaktim të mos bjerë ndesh me normat e Sheriatit.<sup>11</sup>

## Qëllimi i përjetësimit të vakëfit

Siç u pa edhe nga ajo që u tha më sipër, personi i cili e kthen pasurinë e tij në vakëf, këtë e bën për të arritur shpërblimin e Allahut edhe pas vdekjes së tij. Për këtë qëllim Profeti (salallahu alejhi ue selem) thotë: *"Kur njeriu vdes atij i ndërpriten veprat, përveçse në tre raste: Kur ai lë një sadaka të rrjedhshme, një dije nga e cila përfitohet dhe një fëmijë të mirë i cili lutet për të."*<sup>12</sup>

Sadakaja e rrjedhshme është pikërisht ajo pasuri që lihet si vakëf. Nëse vakëfi humbet nga papërgjegjshmëria e të tjerëve, kjo do të thotë që personi i cili e ka lënë atë si vakëf do të privohet nga shpërblimi i saj pas vdekjes. Kjo përbën thyerje të amanetit dhe thyerja e amanetit ndëshkohet nga Allahu. Gjithashtu një akt i tillë përbën shpërdorim të pronës së muslimanëve dhe privon ata nga të ardhurat që vilen nga ky vakëf në dobi të tyre, dhe si i tillë ai është edhe ligjërish të ndëshkueshëm.

## Toka vakëf mbi të cilën më parë ka pasur një xhami

Në rastet kur është prishur xhamia dhe

ka mbetur toka, ajo tokë konsiderohet sipas medhhebit hanefi si xhami deri në Ditën e Kiametit. Dhe sipas mendimeve të dijetarëve të medhhebit hanefi, shafi, hanbeli dhe disa dijetarë të medhhebit maliki; xhamia duhet të rindërtohet në të njëjtin vend, pasi toka mbi të cilën ka qenë ngritur xhamia ngelet xhami edhe nëse xhamia është prishur.<sup>13</sup>

## A lejohet zëvendësimi i vakëfit?

Siç u tha edhe më sipër që tjetërsimi i vakëfit në çfarëdo lloj forme qoftë nuk lejohet, por a lejohet zëvendësimi i tij? Po, lejohet zëvendësimi i tij dhe kjo në dy raste:

**Rasti i parë:** Kur zëvendësimi i tij bëhet i domosdoshëm apo i nevojshëm. Dhe kjo kur ai e humbet vlerën e tij plotësisht, si p.sh. një xhami e braktisur apo edhe e prishur në të cilën nuk falen më njerëz. Në këtë rast lejohet zëvendësimi i tij me një tjetër. Ky zëvendësim bëhet duke u shitur vakëfi i parë me shumën më të mirë të mundshme dhe me këtë shumë të blihet apo ndërtohet vakëfi i dytë, i cili duhet të ketë të njëjtin destinacion si i pari. Dijetarët e vonshëm hanefi si Ibn Abidini e të tjerë, kanë kushtëzuar që ky zëvendësim të bëhet kokë për kokë, dhe nëse është e mundur të mos shitet me të holla për të shmangur abuzimet që bëhen në këto raste.<sup>14</sup> Një kusht tjetër është që vakëfi i zëvendësuar të jetë si i pari ose më i mirë se ai, ndryshe nuk lejohet. Por edhe nëse është me sipërfaqe më të madhe, por ka një vlerë më të ulët se i pari, përsëri nuk lejohet. Disa prej dijetarëve e kanë lejuar që zëvendësimi mund të mos jetë i të njëjtit lloj nëse i dyti sjell të ardhura më të mëdha sesa i pari.<sup>15</sup>

**Rasti i dytë:** Nëse vakëfi me të cilin kërkohet të zëvendësohet është më i mirë se i pari dhe me më shumë të ardhura. Sipas disa dijetarëve hanefi një gjë e tillë lejohet, ndërsa shumica e tyre nuk e lejojnë, sepse nuk përbën domosdoshmëri si në rastin e parë, shtu këtu edhe abuzimet që ndodhin në të tilla raste.<sup>16</sup>

## Investimi nëpër vakëfe

Lejohen investimet që bëhen me qëllim rritjen e të ardhurave që vinë nga vakëfet, pasi vetë vakëfi është një investim nga i cili merren të ardhura të vazhdueshme duke ruajtur kështu kapitalin fillestar. Disa nga format e lejuara nga Sheriati të investimeve që mund të zbatohen në pronat vakëf janë:<sup>17</sup>

• **Dhënia me qira.** Një nga format më të vjetra dhe më të përhapura të shfrytëzimit të vakëfeve. Dijetarët kanë rënë dakord për këtë formë shfrytëzimi, por ka pasur mospajtime rreth disa hollësive siç është koha e dhënies me qira dhe çmimi i qirasë.

1. **Periudha e dhënies me qira:** Sipas hanefive koha e dhënies me qira për një ndërtesë nuk duhet të kalojë një vit, ndërsa për tokat bujqësore nuk duhet të kalojë tre vjet. Fetvaja që jepet tek hanefitë për një qira afatgjatë konsiston në zhvlerësimin e aktit të qirasë. Kjo për arsye se një kontratë e tillë mund të shkaktojë dëmtimin vakëfit për një kohë të gjatë, madje mund të shpjerë deri në asgjësimin e vakëfit. Përfashtohen rastet kur këtë e kërkon interesi i ndërtimit të vakëfit, dhe kjo duke marrë paradhnënie qiranë e viteve të ardhshme. Në një rast të tillë kontrata e qirasë duhet të ripërsëritet vit për vit.<sup>18</sup>

2. **Çmimi i qirasë.** Një pjesë e dijetarëve (prej tyre edhe hanefitë, malikitë dhe shafijtë) kanë kushtëzuar që vakëfi të mos jepet me qira me vlerë më të vogël sesa tregu i një prone të tillë. Nëse vakëfi jepet me vlerë më të vogël, administratori i vakëfit ka të drejtë të prishë kontratën, dhe nëse shtohet vlera e qirasë pas kontratës duhet të ripërtërihet kontrata me vlerën e re.<sup>19</sup>

**Kontrata e qirasë për një kohë të gjatë dhe jo me vlerën reale të tregut nuk është e detyrueshme.** Kontrata e qirasë të të gjithë dijetarët është e detyrueshme,<sup>20</sup> por kur bëhet fjalë për vakëfin nuk konsiderohet si e tillë nëse ajo bëhet për një kohë të gjatë dhe jo me vlerën e tregut. Kjo është një tjetër veçanti e vakëfit.<sup>21</sup>

1 Mu'xhem el-uesit etj.

2 Fikhu Es-suneh 4/330.

3 Transmetuar nga Buhariu (2764), Muslimi (1633), Tirmidhiu (1375), Nesaiu (3603), Ebu Daudi (2878), Ibn Maxha (2396) etj.

4 Xhamiu Et-Tirmidhi, Kitab el-Uakf.

5 Shih El-bahr Er-raik 5/202.

6 Shih Mukhtesar el-kudurij, kapitulli i vakëfit fq.283.

7 Nejl El-eutar, Kapitulli i Vakëfit.

8 Shih Muhtesar el-kudurij, fq. 287, El-hidajetu sherh el-bidaje 3/13, Fikhu Es-suneh 4/335.

9 Shih Hashijetu Ibn Abidin 5/57.

10 Shih Muhtesar el-kudurij, fq.285, El-baher-raik 5/204, Hashijetu Ibn Abidin 4/349.

11 Hashijetu Ibn Abidin 4/343.

12 Transmeton Muslimi, Ebu Daudi, Nesaiu etj.

13 Nga fetvatë e El-ez'herit, Shej Xhadul Hak Ali Xhadul Hak, faqja e ministrisë së vakëfeve egjiptiane: www.islamic-council.com. Shih po ashtu edhe vendimet e dhëna nga Akademia e jurisprudencës islame në Indi, vend ky i dominuar nga dijetarët e medh'hebit hanefi, marrë nga Fikh En-neuazil 4/499 dok. nr. 339 e Dr. Muhamed El-xhizani.

14 Hashijetu Ibn Abidin 4/386.

15 Po aty. Disa prej dijetarëve hanefi siç është Es-serkhasi nuk e kanë lejuar zëvendësimin e vakëfit në asnjë lloj rasti, në mënyrë absolute. (El-bahr er-raik 5/222).

16 Shih Hashijetu Ibn Abidin 4/384, 386, 388, El-bahr er-raik 5/222.

17 Shkëputur nga studimi Istithmar el-uakf ue turukuhu el-kadime uel-hadithe, Dr. Ali Muhjedin Dagi.

18 El-fetaua el-hindije (419/2)

19 Hashijetu ibn Abidin 3/391, El-fetaua el-hindije 2/419, Fethul el-alij el-malik 2/239, Mugni el-muhtaxh 2/395, Er-reudatu 5/352, El-fikh el-islami ue ediletuhu 8/236.

20 Tuhfetu el-fukahai 2/514, Bidajetu el-muxhtehid 2/372, Reudatu et-talibin 5/173, El-kafi i Ibn Kudames 2/300.

21 Hashijetu ibn Abidin 4/402, Fethul el-alij el-malik 2/239.

## Gazeta LIDHJA - e përtrejavshme

Bordi botues:  
Justinian Topulli  
Genc Plumbi  
Mustafa Tërnici

Redaktor përgjegjës:  
Roald A. Hysa

## LIDHJA HOXHALLARËVE TË SHQIPËRISË

Unaza e Re, Rruga: Teodor Keko mbi Alfa Bank, Tirane-Shqipëri  
lidhjahoxhallareve@yahoo.com

Tel & Fax: +355 (0)48320160

http://www.lidhjahoxhallareve.com


# Oazi i shpirtit / Surja Fatiha dhe lumturia e njeriut

Nga Shejhul Islam Ibn Kajim el-Xheuzije

Njeriu ka dy mundësi: njëren që ka të bëjë me dijen teorike dhe tjetren që është praktikimi i vullnetshëm. Lumturia e njeriut qëndron pikërisht në plotësimin dhe përsosmërinë e këtyre dy mundësive, dijen dhe praktikën.

Mundësia e dijes përsoset duke njohur Krijuesin, Zotin e gjithësisë, emrat dhe cilësitë e Tij, rrugën që të çon për tek Ai, shkarjet që të largojnë prej Tij. Po ashtu njeriu duhet të njohë vetveten me dobësitë dhe gabimet që ka. Me anë të këtyre pesë njohurive arrihet përsosmëria e mundësisë së dijes dhe, njerëzit më të ditur janë ata që më së miri i njohin këto gjëra dhe i kuptojnë ato.

Mundësia e praktikës dhe e vullnetit, nuk mund të përsoset vetëm se duke vënë në jetë detyrimet që njeriu ka ndaj Zotit, me vërtetësi, sinqeritet, përkushtim, ndrojtje dhe duke pranuar se nuk ia ka dhënë Krijuesit të tij hakun që i takon dhe e meriton. Njeriu duhet ta pranojë se nuk mundet t'i përsosë këto dy mundësi përveçse me ndihmën e Allahut, ai ka nevojë së tepërmi që të udhëzohet në udhën e drejtë, në udhën që ecën eulijatë dhe njerëzit e Zotit. Njeriu ka nevojë për ndihmën e Allahut, që të mos shkasë nga udha e drejtë me shkatërrimin e mundësisë së dijes dhe për rrjedhim, rënien në humbje; apo me shkatërrimin e mundësisë praktike dhe për rrjedhim, rënien në zemërimin e Allahut. Përsosmëria e njeriut dhe lumturia e tij, plotësohet vetëm duke mbledhur të gjitha këto aspekte, të cilat mjaft bukur janë përshkruar në suren Fatiha:



Fjala e Allahut: "Gjithë lavdërimet dhe falënderimet janë për Allahun, Zotin e të gjitha botëve. I Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti. I Vetmi Mbisundues i Ditës së Shpërblimit (Ditës së Ringjalljes)" (Fatiha, 1-3), përmban elementin e parë që është njohja e Zotit, emrave, cilësive dhe veprimeve të Tij. Emrat e Allahut të përmendur në këtë sure, përbëjnë bazën e emrave të bukur të Allahut, e ata janë: Allah, Zot dhe i Gjithëmëshirshëm.

Emri Allah, tregon cilësitë hyjnore të Zotit dhe adhurimin që krijesat duhet t'i kushtojnë Atij.

Emri Zot, tregon cilësitë që kanë të bëjnë me Plotfuqishmërinë dhe zotërimin Absolut të Tij.

Emri i Gjithëmëshirshëm, tregon cilësitë e Mirësisë dhe Bujarisë së Zotit.

Kuptimet e të gjithë emrave të Allahut, përsillen rreth këtyre tre emrave.

Fjala e Allahut: "Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm Ty të mbështetemi e të kërkojmë ndihmë" (Fatiha, 4), tregon njohjen e rrugës që të shpie për tek Allahu, e cila nuk është gjë tjetër veçse adhurimi i vetëm i Tij, ashtu siç Ai dëshiron dhe është i kënaqur dhe kjo arrihet me ndihmën dhe përkrahjen e Tij.

Fjala e Allahut: "Përforcona (drejtona) në Rrugën e Drejtë." (Fatiha, 5), tregon se njeriu nuk mund ta arrijë lumturinë, vetëm se duke iu përmbajtur rrugës së drejtë dhe nuk mund t'i përmbahet kësaj

gjëje vetëm se me anë të udhëzimit që i jep Zoti i tij, ashtu siç nuk e kryen dot adhurimin vetëm se me ndihmën e Tij, andaj gjithçka varet nga udhëzimi i Allahut.

Fjala e Allahut: "Jo në (rrugë) të atyre që e merituan Zemërimin Tënd mbi vete dhe as në (rrugë) të atyre, të cilët e humbën veten." (Fatiha, 7), tregon dy llojet e shmangieve nga rruga e drejtë. Njëra shmangie shpie në humbje dhe vjen si rezultat i padijes dhe besimit të gabuar, ndërsa shmangia tjetër shpie në zemërimin e Allahut dhe vjen si pasojë e qëllimit të keq dhe punës së padobishme.

Fillimi i sures Fatiha trajton Mëshirën e Allahut, mes i saj Udhëzimin, dhe fundi Mirësinë e Tij.

Njeriu do të përfitojë nga kjo mirësi për aq sa ai është i udhëzuar, dhe ai është i udhëzuar për aq sa është mëshiruar nga Allahu. Pra, e gjithë çështja përsillet rreth Mirësisë dhe Mëshirës së Allahut. Mëshira dhe Mirësia janëtribute që vijnë si rrjedhojë e Plotfuqishmërisë dhe Zotërimin Absolut të Allahut. Ai nuk mund të jetë vetëm se i Mëshirshëm dhe Mirëbërës, cilësi këto që rrjedhin nga Hyjnia e Tij; Ai është i Adhuruari i Vërtetë, edhe nëse nuk e pranojnë Atë ateistët, apo i bëjnë ortak politeistët.

Kushdo që kupton dhe vë në jetë përmbajtjen dhe kuptimet e sures Fatiha, do të arrijë përsosmërinë më të madhe dhe adhurimi i tij ndaj Allahut do të arrijë gradën e njerëzve të veçantë, të cilët qëndrojnë shumë më lart se sa adhuruesit e thjeshtë. Allahu na ardhte në ndihmë!

## Urtësi

Nga Shejhul Islam Ibn Kajim el-Xheuzije

*Kur ne udhetojmë e ti na je prijës,  
Era jote e kandshme u mjafton kafshëve për udhëheqje*

*E në e humbshim rrugën e në mbetshim pa ndihmës*

*Drita e fryrës tane na bahet mbështetje.*

• Gjynahet janë plagë. Ndoshta plaga qëllon të jetë aty ku të shkakton vdekjen.

• Nëse arsyeja jote del jashtë sundimit të pasioneve, atëherë pushteti është në duart e saj.

• Kur ti hyre në shtëpinë e qejfeve nuk bërë gjë tjetër vetëm se e hodhe jetën tënde në bixhoz.

• Kur para teje shfaqet diçka që nuk të lejohet ta shohësh, dije se ajo është provokuesja e një lufte, ndaj mbrohu prej saj me "Thuaju besimtarëve që të ulin shikimin" (Nur, 30), dhe kështu do të shpëtosh prej pasojave: "Dhe Allahu ua largoi luftën besimtarëve." (Ahzab, 25)

• Kur niveli i detit të pasioneve rritet, të mbyt. Pika më e dobët për notarin në të është hapja e syve në brendësi të tij.

• Nuk ka njeri më të nderuar në varr sesa ai të cilit i bëjnë shoqëri veprat e tij, duke shijuar në këtë varr kopshtin e lulëzuar. Krejt ndryshe ndodh me atë që varrin e ka si burg. Njeriut i vinë sprovat sipas vlerës. Çdokush njihet kur duron sprovat.

• Ai që durimin e ka të pakët, ndaj asaj që i ruhet, sigurisht që edhe kështu do të shpreson do ta ketë të pakët.

• Blije veten tënde, sepse tregu është akoma i hapur dhe koston e ke në dorë.

• Patjetër do të të kapë dremitja e haresës dhe do të zësh shtratin e pasionit, por bëje gjumin të lehtë, sepse rojet e kështjellës po thërrasin: Erdhi mëngjesi!

• Drita e mendjes ndriçon në natën e errët të pasionit dhe tregon rrugën e duhur: në këtë dritë i mençuri shikon prapavijën e gjërave.

• Dil me vendosmëri nga ky shesh i ngushtë, i mbushur me probleme, për te sheshi i gjerë, në të cilin ka gjëra të cilat syri nuk t'i ka parë: atje do të gjesh gjithçka që kërkon dhe dëshiron.

• O ti që veten ia ke shitur pasionit, dashuria për të cilin është lodhje dhe lidhja me të torturë, e fundi i tij zhdukje! Gjënë më të shtrenjtë e ke shitur me një çmim të lirë! A nuk ia di vlerën mallit dhe çmimin e shtrenjtë që ka ai?! Kur ti të vish ditën që bëhen llogaritë e blerjes, do të shohësh sesi ke humbur në këtë tregti. Malli yt është 'La ilahe il-Allah' dhe blerësi i tij është Allahu, vlera e saj është Xheneti, sekseri i kësaj tregtie është Profeti. A kënaqesh duke e shitur këtë mall për pak gjë, që nuk vlen as sa krahu i një mushkonje?!

## Besnikëria dhe sinqeriteti

Nga Abdullah ibn Mes'udi (Allahu qoftë i kënaqur prej tij) transmetohet se i Dërguari i Allahut ka thënë: "Keni detyrë që të jini të drejtë, sepse kjo të shpie në të mira, ndërsa të mirat të shpien në xhenet. Njeriu vazhdon dhe përpiqet gjithnjë të thotë të drejtën derisa të shkruhet e te pranohet te Allahu njeri i sinqertë. Kini kujdes e ruhuni nga gënjeshtria, sepse ajo të shpie në shturje, kurse shturja të shpie në zjarr. Njeriu vazhdon dhe përpiqet gjithnjë të gënjejë derisa të pranohet te Allahu si gënjeshtar." Buhariu dhe Muslimi

Nga Hakim ibn Hizami (Allahu qoftë i kënaqur prej tij) transmetohet se Profeti (alehissalatu uesselam) ka thënë: "Shitësi dhe blerësi janë të lirë të zgjedhin përderisa nuk janë ndarë. Nëqoftëse janë të sinqertë dhe transparentë me njëri tjetrin do të bekohen të tregtinë e tyre. A nëse ata gënjejnë dhe fshehin të metat, atëherë do t'u ikë begatia nga tregtia e tyre." Buhariu dhe Muslimi

Nga Hasani i biri i Aliut (Allahu qoftë i kënaqur prej tyre dyve) përcillet se ka thënë: "Kam memorizuar nga i Dërguari i Allahut këto fjalë: "Lëre atë që është e dyshimtë dhe shko pas asaj që nuk është e dyshimtë. Vërtet sinqeriteti është qetësi shpirtërore ndërsa gënjeshtria është dyshim." Tirmidhiu

# Ekonomi / Ekonomia Islame - nga parimet në praktikë

Nga Muhamed Eshref



Shumë njerëz përipiqen gjithmonë si përshtasin Parimet Ekonomike Islame brenda terminologjisë moderne ekonomike, në vend që të marrin një qasje të anasjelltë, pa e kuptuar fare faktin, që kjo terminologji moderne e ka origjinën nga Grekët apo kërkimet e ekonomistëve muslimanë. Me qëllim që ta heqim këtë keqkonceptim me këtë artikull do të përipiqemi të ndriçojmë origjinën e koncepteve moderne ekonomike dhe aspektet kyçe të Ekonomisë Islame, duke përfshirë këtu edhe politikën monetare e fiskale nga parimet në praktikë.

## Bazat e politikës monetare

Politika konvencionale monetare mund të gjurmohet mbrapa në kohë deri nga fundi i shek. XIX, kur standardi ishte ari, i cili në formën moderne njihet kallëpi standard i arit (KSA). KSA është një sistem në të cilin nuk qarkullojnë monedha ari, por në të cilin autoritetet kanë rënë dakord të shesin kallëpe ari sipas kërkesës për një çmim të fiksuar në këmbim të monedhës në qarkullim. Deri në vitin 1971 shumë monedha të botës mbështeteshin nga ari. Befasisht vlera aktuale e parasë letër apo elektronike nuk u mbështet me ar, por mund të rregullohej nga krijuesit e monedhës.

Politikat monetare përipiqen ta stabilizojnë ekonominë, duke kontrolluar përqindjet e interesit dhe të shpenzimeve, duke i kufizuar borxhet qeveritare. Politika monetare

është një pengesë e madhe për ekonominë e lirë të tregut, sepse qeveria e kontrollon ekonominë nëpërmjet politikës monetare, e cila nuk mundësohet në një ambient që funksionon me ar. Kjo është ajo çka ndodhi saktësisht në të ashtuquajturin Ekonomi e Tregut të Lirë Kapitalist më 1931, kur zëvendësimi i monedhave të arta u ndalua nga bankat. Me kalimin e kohës vetëm për të kontrolluar të ashtuquajturën Ekonomi të Lirë nëpërmjet politikave monetare u futën shtesa sipër shtresave politikave, ku në fillim u fut monedha, dhe më pas pozitat minuese monetare u mbuluan nëpërmjet rregullimit të librave të llogarive, dhe tashti nëpërmjet koncepteve të parasë plastike.

## Politika monetare në Islam

Konceptet parësore të ekonomisë së lirë janë tashmë të pranishme Parimet Ekonomike Islame (PEI). PEI janë rreptësisht kundër përqendrimit të pasurisë dhe e ndalon nëpërmjet asaj edhe të keqen e Ribasë- (interesit kamator). Në të kundërt me politikën monetare konvencionale PEI nuk vuan nga e keqja e përqindjeve të interesit, nga benefitet e shtypjes së parave dhe marrja borxh nga popullata nëpërmjet formave të ndryshme si bonot etj. Meqë koncepti i interesit mungon në PEI, së këndejmi koncepti i politikës monetare në PEI është i kufizuar vetëm në standardin e arit, gjë për të cilën është zhvilluar qysh në fillimet e veta.

Standardi i arit bazohet në parimet islame. Islami i konsideron mallrat me vlerat e tyre të brendshme si monedhë. Mallrat në vijim janë shembull i përdorimit si monedhë: Ari, Argjendi, Orizi, Hurmat, Mielli, Elbi dhe Kripa. Çmimi i një malli vendoset nga vetë tregu pa ndonjë ndërhyrje qeveritare. Koncepti i parasë ishte mbizotërues edhe përpara profetit të fundit Muhamedit (alejhi selam), ku 1 dinar ari ishte baraz me 10 dërhëmë argjendi. Edhe sot argjendi ka një barazi të caktuar me arin. Argjendarët zakonisht përdorin vula në dinarin dhe dërhemin për të provuar autenticitetin.

Në shumë rrëfime historike shpallet

se ndërmjet Kalifëve të Drejtë ishte Osman ibni Afani r.a. ka qenë i pari që nxori monedha, ndërsa disa transmetime të tjera shpallin se ka qenë Omeri r.a. i pari që e bëri një gjë të tillë. Kur u mor Persia tre lloje monedhash qarkullonin në këto territore, me emrat Baghli prej 8 dang; Tabariu prej 4 dang; dhe Magribiu prej 3 dang. Omeri (sipas disave Osmani) futën një risi dhe nxorën dërhemin islam prej 6 dang. Sipas PEI roli i Bankave Qendrore nën PEI do të ishte për një Tregti Ndërkombëtare Kontabiliteti për vendin, produkte të shqyrtuara në përputhje me Sheriatin dhe për rregullimin e institucioneve financiare. Për pasojë koncepti i bankimit nën PEI do të ofronte Produkte Financiare sipas Sheriatit si ndërmjetëse, depozita ari për klientin dhe konvertimin e monedhës në ar në llogari të kërkesës së mbajtësit përveç trajtimit të monedhës në një fazë tranzitore.

## Bazat e politikës fiskale

Politika fiskale kontrastohet me politikën monetare, e cila përipiqet ta stabilizojë ekonominë duke kontrolluar normat e përqindjes së interesit, normat e këmbimeve dhe furnizimin me para. Ajo përdor dy instrumente kryesore- shpenzimet qeveritare dhe taksimin. Ndryshimet në nivelin dhe kompozimin e taksimit dhe shpenzimet qeveritare mund të zbatohen në variablet ekonomike në vijim:

- Kërkesën në total dhe në nivelin e aktivitetit ekonomik
- Në modelin e alokimit të burimeve
- Shpërndarjen e hyrjeve

## Bazat e ekonomisë keinesiane

Ekonomia keinesiane e quajtur edhe keinesianizmi apo teoria keinesiane është një shkollë e mendimit makro-ekonomik e bazuar në idetë e ekonomistit të shek. XX Xhon Majnard Keines. Ekonomia keinesiane argumenton, se vendimet e sektorit privat nganjëherë çojnë në rezultate ineficente makro-ekonomike dhe për këtë mbron ndërhyrjen e politikave aktive të sektorit pub-

lik, duke përfshirë këtu ndërhyrje të politikave monetare nga banka qendrore dhe ndërhyrje të politikave fiskale nga qeveria për të stabilizuar prodhimin e ciklit të biznesit. Teoritë që dormojnë bazën e ekonomisë keinesiane u paraqitën fillimisht në librin "Teoria e përgjithshme e punësimit, Interesave dhe Parasë" botuar më 1936. Interpretimet e Keinesit janë kontroversiale dhe shkolla të ndryshme mendimi e pretendojnë trashëgiminë e tij.

Ekonomia keinesiane mbron idenë e një ekonomie të përzier- ku mbizotëron sektori privat, por me një rol domethënës të qeverisë dhe sektorit publik- dhe shërbeu si modeli ekonomik pas Krizës së Madhe (1929), Luftës II Botërore dhe ekspansionit ekonomik pas-lufte (1945-1973), megjithatë ai e humbi disi ndikimin pas stagflacionit (stancion e inflacion ekonomik njëkohësisht) të viteve 1970. Ngjarja e krizës financiare globale e 2008 ka shkaktuar rigjallërimin e mendimit keinesian.

## Politika fiskale në Islam

Gjatë qeverisjes islame të Medines ndodhi një shndërrim shoqëror si rezultat i ndryshimit të pronësisë së tokës, duke i dhënë individëve të çdolloy gjinie, etnie apo me të kaluar fetare të drejtën për të blerë, shitur, dhënë me qira dhe për ta trashëguar tokën. Bazuar në Kurani Famëlartë duhen firmosur kontrata për transaksione të mëdha financiare, që kanë të bëjnë me bujqësinë, industrinë, tregtinë dhe punësimin. Kopjet e kontratave duhen ruajtur zakonisht nga të dyja palët e përfshira në marrëveshje, dhe së këndejmi të gjithë ajo që ne jemi duke praktikuar tashti nuk është diçka e huaj për Parimet Ekonomike Islame-PEI. Siç dihet mirë tashmë, që PEI janë të dedukuara nga Kurani dhe Suneti. Mendimtarët e hershëm ekonomikë islamë kanë zhvilluar modele të ndryshme ekonomike, që formojnë bazën konkrete të parimeve moderne ekonomike.

Marrë nga <http://www.islamonline.com/news/articles/105/Principle-to-Practice--ISLAMIC-ECONOMICS.html>

# Ringjallja e tokës djerrë në Islam

Përgatiti hoxhë Genc Plumbi

Islami e ka ligjëruar ringjalljen e tokës së vdekur (djerrë) dhe vënien e saj në efikasitet, sepse prej këtij procesi përfiton e gjithë shoqëria dhe individitet, pra përmes mbjelljes së tokës dhe ndërtimit të saj. Në këtë mënyrë shtohet prodhimi dhe shoqëria realizon një jetë më të mirë ekonomike. Gjithashtu kjo formë e vënies në efikasitet të tokës bën të mundur të tejkalohen shumë probleme shoqërore, siç është mbipopullimi, mungesa e ushqimit dhe problemi i krahut të punës, sepse zgjerimi i tokave të punuara kërkon domosdoshmërisht një numër të madh krahu pune.

Ringjallja e tokës djerrë do të thotë dorëzimi i saj tek një individ, me qëllim që ta rikthejë në jetë atë dhe pasi ta ketë realizuar diçka të tillë, ajo kthehet në pronë të tij dhe njëkohësisht nuk lejohet të rimerret prej tij, apo të shpronësohet padrejtësisht, pa marrë parasysh nëse kjo tokë është kthyer me apo pa lejen e mëkëmbësit. Pra sipas Islamit ringjallja e tokës së vdekur përbën një nga shkaqet e pronësisë. Ndërsa parcelizimi i tokës do të thotë që mëkëmbësi t'u japë një grupi njerëzish apo një individit një parcelë toke djerrë, apo një tokë të pasur me minerale, apo me ujë për një interes të caktuar. Vetë i Dërguari i Allahut a.s. i ka ndarë sahabeve parcela tokash dhe në të njëjtën mënyrë kanë vepruar edhe Halifët

e Drejtë – Allahu qoftë i kënaqur prej tyre.

Nga Amër bin Dinari na përcillet se ka thënë: "Kur na erdhi i Dërguari i Allahut a.s., ai u ndau parcela Ebu Bekrit dhe Omer bnin Hatabit, Allahu qoftë i kënaqur prej tyre."

Mëkëmbësit i lejohet t'i japë një parcelë toke vetëm dikujt që i ka mundësitë e ringjalljes së asaj toke, sepse përndryshe kjo do t'i zinte ngushtë muslimanët. Ndarja e një parcele toke nuk do të thotë domosdoshmërisht, se është fituar pronësia mbi të, por do të thotë se personi që e ka marrë përipër ka të drejtë të përfitojë prej saj dhe mëkëmbësi mund t'ia rimarrë përsëri nëse dëshiron në çdo kohë nëse e sheh të arsyeshme.

I Dërguari i Allahut a.s. i ka nxitur besimtarët të investojnë tek toka dhe që t'i vendosin ato në efikasitet, duke thënë: "Kush e ringjall një tokë të vdekur, ajo i përket atij." Dhe në një hadith tjetër thotë: "Kush e ringjall një tokë që nuk i përket askujt, ai e meriton më shumë atë, se sa kushdo tjetër." (Buhariu, Ahmedit dhe Bejhakiu)

Për ringjalljen e një tokë djerrë duhen plotësuar këto kushte:

1- Toka duhet të jetë në vendet e muslimanëve, sepse në vendet e jomuslimanëve nuk mund të ndërmerret diçka e tillë vetëm se me lejen e tyre.

2- Toka që synojmë të ringjallim të mos jetë pronë e dikujt, qoftë në pronësinë e një muslimani apo jomuslimani. Nëse vër-

tetohet pronësia e dikujt mbi tokën, atëherë pronari ka të drejtë të kërkojë kompesim për punimin e tokës, apo blerjen e saj prej atij që dëshiron ta ringjallë.

3- Toka të jetë afër ndërtesave dhe jo pjesë e pasurisë publike, siç janë rrugët, lulishtet etj. në të cilat mblidhen njerëzit.

Ringjallja e tokës të bëhet me lejen e autoriteteve përkatëse. Dijetarët janë pajtuar për faktin se ringjallja e tokës përbën një nga shkaqet e pronësisë, por ata kanë mbajtur qëndrime të ndryshme në lidhje me domosdoshmërinë e autoriteteve për diçka të tillë. Pjesa më e madhe e dijetarëve janë të mendimit, se kush e ringjall një tokë, ajo i përket atij dhe trashëgimtarëve të tij, dhe se autoritetet e kanë për detyrë t'ia njohin atij pronësinë mbi tokën, dhe nuk kanë asnjë të drejtë që t'ia heqin këtë të drejtë. Argument për këtë është fjala e të Dërguarit të Allahut a.s. në hadithin e përcjellë nga Xhabir bin Abdullahi r.a.: "Kush e ringjall një tokë të vdekur, ajo i përket atij." Buhariu.

Nëse përmushen këto kushte, atëherë individit mund të fillojë me procesin e ringjalljes së tokës dhe të përfitimit prej saj, dhe prej të gjithë infrastukturës përreth saj për të cilën ai ka nevojë. Gjithashtu ky proces ka nevojë të shoqërohet me synimin për të realizuar ringjalljen e tokës, dhe ky synim nuk mund të jetë i tillë pa e filluar pastrimin e tokës nga ferrat dhe barishtet e dëmshme, por duke e punuar atë dhe duke

ndërtuar mbi të. Nëse individit që ka marrë përsipër këtë detyrë e braktis tokën pa punuar për një periudhë tre vjeçare, atëherë ai privohet nga pronësia mbi të. Argument për këtë është, se i Dërguari i Allahut a.s. i dha fiseve Xhehine dhe Mezineh një parcelë tokë dhe ata nuk e punuan atë. Pas tyre erdhën njerëz të tjerë që e punuan tokën dhe të dyja palët shkuan për gjykim tek Omer bin Hatabi r.a., i cili iu tha: "Po të kishte qenë prej meje ose prej Ebu Bekrit, unë kisha për ta kthyer tokën (do ta merrja), por ajo është një parcelë që e ka dhënë i Dërguari i Allahut a.s." Pastaj tha: "Kush ka një tokë që e lë pa punuar për tre vjet dhe nuk e ndërton atë, dhe pas tij vjen një popull që e punon, atëherë ata të tjerët e meritojnë më shumë atë."

Nëse toka që ka marrë përsipër individit që dëshiron ta ringjallë është tepër e gjërë dhe nuk ia arrin qëllimit për ta venë në jetë, atëherë atij i merret ajo pjesë e tokës, të cilën ai nuk arrin ta punojë dhe i jepet një tjetri që mund ta punojë. Nga Bilal bin Harithi r.a. na përcillet, se i Dërguari i Allahut a.s. i kishte dhënë atij një parcelë tokë në Akik (luginë në Medine). Kur erdhi koha e Omerit r.a., ai iu drejtuar Bilalit me fjalët: "I Dërguari i Allahut a.s. nuk ta ndau parcelën që të privosh njerëzit prej saj, por ta dha që ta punosh atë. Prandaj merr atë pjesë tokë që ke mundësi ta punosh dhe ktheje pjesën tjetër." (Bejhakiu).

# Histori / Ripërtëritja e figurave dhe vlerave të vërteta qytetare

Nga Bled KOMINI\*



## Njohja e vlerave dhe meritave të munguara

Ardhja e demokracisë dhe ndryshimet e para pluraliste sollën me vete edhe ndryshimin e vetëdijes sociale, kulturore e fetare për popullin shqiptar. E kaluara e hidhur komuniste dhe shtypja e madhe që pësoi populli jonë gjatë diktaturës pothuajse pesëdhjetë vjeçare, krijuan një stereotip social që kulmoi me “njeriun e ri”. Në fakt ky “njeri i ri”, nuk ishte gjë tjetër vetëm se një produkt i diktaturës më të shëmtuar në botë. Për fatin e mirë, shqiptarët e rrëzuan diktaturën komuniste njëzet e dy vjet më parë, ndërsa produkti i saj më i shëmtuar, “njeriu i ri”, mbeti.

Mbetjet e regjimit komunist vijuan të ndjehen edhe pas viteve '90. Mos njohja e vlerave të vërteta sociale, atyre historike si dhe atyre kulturore e fetare, bëri që populli ynë të vuaj edhe pas viteve '90, mungesën e modeleve të shëndosha dhe pozitive, prej të cilave ai do të frymëzohej për të ndërtuar shoqërinë e vlerave dhe demokracisë. Njëherazi nëpërmjet këtyre modeleve frymëzimi edhe tranzicioni do të ishte më i paqtë dhe më i shpejtë.

Në ditët që shkuan të festimeve mbi 100-vjetorin e Shpalljes së Pavarësisë dhe ngritjes së flamurit tonë kombëtar në Vlorë u ndërmorën shumë iniciativa, festime e dekorime të figurave të ndryshme vendore e kombëtare. Megjithëse disa patriotë dhe figura të shquara që kanë spikatur dhe janë stigmatizuar për punën e tyre gjatë

kohës që kanë qenë gjallë, jo vetëm që nuk u dekoruan por emri i tyre as që u përmend. Sakaq shqiptarë dhe besimtarë të mirë që kanë dhënë një kontribut të vyer, që nga momenti i ngritjes së flamurit të pavarësisë në Vlorë dhe në shumë qytete të tjera, si dhe në vitet e më pasme, dallojnë emrat e H. Vehbi Dibrës, H. Sherif Langut, H. Ali Korçës, H. Ismail Ndroqit, H. Ibrahim Repishtit, H. Ibrahim Dalliu, H. Xhemal Naipit, H. Kadri Prishtina etj., asnjë prej tyre nuk u përmend në të gjitha festimet.

Asnjë prej këtyre hoxhallarëve patriotë, të cilët nuk e ndanë nga jeta e tyre binomin “Fe e Atdhe”, nuk mori qoftë edhe një medalje të zakonshme si mirënjohje e këtij kombi për të gjithë atë punë të kryer në dobi të Shtetit Shqiptar dhe të Çështjes Kombëtare.

I gjendur në qerthullin e dilemës mbi faktin se a duhet reaguar apo jo që këto figura të zënë vendin e merituar, vendosa të shkruaj disa rreshta fillimisht si blatim për figurën, veprën dhe personalitetin e tyre. Mirëpo kurmi i krijimtarisë së tyre më obligoi që përveç shkrimit të ngre dhe zërin në disa media, se kjo punë nuk duhet lënë me kaq. Evidentimi dhe më pas ndjekja e hapave për njohjen e meritave të munguara është vetëm njëra nga etapat që duhen ndjekur në lidhje me këto personalitete.

Fatkeqësisht përpjekja institucionale ka munguar tërësisht gjatë këtyre viteve. Kësaj i është shtuar dhe doza e injorancës që ka shoqëruar shpeshherë ndërrimet në administratën shtetërore si dhe atë të institucioneve që kanë lidhje me trashëgiminë kulturore, duke humbur dhe atë grusht të pakët specialistësh që ja thoshin në lidhje me të kaluarën. E duke qenë se janë institucionet ato që duhet të përkujdesen për këto figura historike dhe të rëndësishme për vendin tonë, kjo përpjekje institucionale ka qenë pothuajse jo ekzistuese, gjë e cila ka shpënë në “amortizimin” e informacionit dhe lënien në harresë të tyre.

Sot pas dy dekadash e gjysmë kohe post-komuniste, një pjesë e madhe e figurave historike dhe atyre që kanë dhënë një kontribut të madh për shoqërinë shqiptare për vite me radhë dhe të cilat u përdhosën dhe u vranë si në të gjallë dhe në të vdekur prej regjimit komunist, pa

dashje ose dhe me qëllim, janë harruar dhe kujtimi i tyre ruhet vetëm prej një dore historianësh dhe dashamirësish.

E gjej me vend të them se pa kontributin e këtyre figurave, historia e popullit tonë dhe ajo e qytetit të Tiranës nuk do të kishte qenë ajo që ishte dhe në të njëjtën kohë qytetaria do të kishte humbur pjesën e saj më vitale. Të flasësh për besimin në Shqipëri dhe në veçanti për komunitetin e besimtarëve mysliman shqiptar është një vështirësi e dyfishtë. Në radhë të parë, vështirësia vjen nga rrjedha historike. Kjo pasi shumë figura të ndritura janë zhdukur nga faqet e historisë ose më e vogla pasojë është se kontributi i tyre është minimizuar në maksimum dhe e tërë kjo erdhi prej dhunës ideologjike dhe institucionale të ushtruar nga partia-pushtet (komuniste).

Në radhë të dytë vështirësia vjen se ato figura të ndritura që dhanë jetën e tyre janë tashmë të ndara prej nesh dhe në shumicën e tyre kanë shkuar tek Krijuesi. Kështu burimi i njohurive për të kaluarën mbetet në dokumentet që ata kanë lënë, ose në kujtesën e bashkëkohësve të tyre.

Ajo çfarë ne në ditët tona perceptojmë si një identitet shqiptar nuk është më pak sesa një përzierje influencash, të cilat filluan që në kohërat e Perandorisë Romake deri në fundin e Perandorisë Bizantine e asaj Osmane. Një fakt i mirënjohur, i cili gjithashtu është riafirmuar dhe në rrethet akademike pas rënies së komunizmit si dhe nga personalitetet më të shquara të kulturës sonë e më gjerë, është që influencat më të fuqishme në kulturën dhe identitetin tonë derivojnë (për mirë apo për keq) nga kohërat osmane.

Këto influenca të fuqishme shihen kudo, si në folklorin tonë, në ritualet sociale të jetëve tona të përditshme, në perceptimet tona të së shenjtës, në urbanizimin dhe arkitekturën e qyteteve tona dhe gjithashtu të gjuhës dhe terminologjisë sonë. Me fjalë të tjera, këto influenca i kanë dhënë formë vetë memories sonë kolektive dhe na kanë ndihmuar të krijojmë identitetin kulturor shqiptar. Ky identitet është një nga shumë identitetet post-osmane që lulëzuan pas rënies së Perandorisë Osmane. Në territoret shqiptare, ku maxhoranca e popullatës janë myslimanë,

ky identitet post-osman, kontribuoi me shumë figura të shquara që dhanë jetën e tyre për pavarësinë e vendit tonë dhe formimin e shtetit shqiptar. Një pjesë e madhe e këtyre figurave dhanë një kontribut të rëndësishëm në jetën qytetare, duke u kthyer në pishtarë për të përhapur vetëdijen se ne jemi shqiptarë dhe myslimanë në të njëjtën kohë.

Prej këtyre figurave një pjesë e madhe e tyre u përfshinë dhe në jetën sociale e kulturore duke mbështetur qeveritë e ndryshme që erdhën pas Pavarësisë. Ata i gjen kudo; mësues të shkëlqyer, përhapës të gjuhës shqipe, eruditë, bashkiakë e kryebashkiakë, ekonomistë, historian, politolog etj. Pavarësisht kontributit që dhanë, regjimi komunist zgjodhi metodën më të egër për të zhdukur ndikimin e tyre, atë të eliminimit fizik dhe fshirjes nga memoria sociale. Ishte pikërisht ky eksperiment i cili sot ne na ka krijuar boshllëqe të mëdha në kujtesën kolektive si dhe në pasjen e modeleve të shkëlqyera për shoqërinë tonë. Në këtë pikë shtrohet një pyetje: Çfarë duhet të bëjmë për të rikthyer kujtimin e tyre dhe për t'i njohur ato vlera që ju mohuan për dekada të tëra me radhë?

Pyetjes se çfarë duhet të bëjmë, po i përgjigjem vet, me shpresën se kjo përgjigje mund të shërbejë si një busull për të orientuar ata që duan të japin një kontribut sado të vogël në këtë fushë. Mendoj se nevojitet vetëm një ndërgjegjësim më i madh social mbi këto figura, të cilat kanë shërbyer me ndershmëri sa ishin gjallë dhe për sa janë të vdekur. Ky ndërgjegjësim do t'i shërbejë më pas modeleve të munguara hera-herës ose të zhdukura të harmonisë dhe bashkëjetesës fetare. Për më tepër ata do t'i shërbejnë gjithashtu edhe brezave të rinj si një model intelektivi, erudicioni, përgjegjshmërie, besimi dhe humanizmi.

Të gjitha këto modele gjenden në krizë në ditët e sotme, për këtë arsye jo vetëm këto personalitete por të gjithë ato personalitete që kanë dhënë të njëjtin kontribut duhet të trajtohen me respekt dhe mirënjohje për atë që lanë pas.

\* Autori është analist dhe shkrimi është botuar në gazetën Tirana Observer.

# Analizë / Hadithet e dobëta dhe të trilluara dhe dëmi i tyre në mesin e muslimanëve

Nga hoxhë Mustafa Tërniqi

Allahu i Madhëruar e plotësoi fenë Islame me shpalljen hyjnore, e cila përfshin Kuranin dhe Sunetin, traditën profetike. Ne si besimtarë musliman besojmë, se as Kurani dhe as Feja Islame nuk mund të shpjegohen pa hadithet e Profetit Muhamed (alejhissalatu ues-selam). Është e rëndësishme të vihet në dukje se hadithet e transmetuara ndahen në hadithe të sakta/autentike (sahih) dhe të pasakta/joautentike (daife). Kjo do të thotë se jo çdo hadith, që e dëgjojmë apo e lexojmë e ka thënë me të vërtetë Profeti (alejhissalatu ues-selam). Shumë hadithe janë të sajura e të trilluara nga gënjeshhtarë të ndryshëm gjatë shekujve dhe shumë të tjera janë të dobëta, sepse nuk plotësojnë kushtet që kanë vënë dijetarët e hadithit, për të dalluar hadithin e saktë nga i pasakti.

Pra, sipas rregullave bazë të shkencës së

hadithit nuk vërtetohet autenticiteti i tyre dhe për pasojë, nuk lejohet argumentimi me to, sidomos në lëmin e Akides dhe Fikhut. Muhadithinët dhe dijetarët e mëdhenj të shkencës së hadithit kanë bërë një punë kolosale në këtë disiplinë delikate dhe iu kanë lënë brezave të mëvonshëm një trashëgimi të madhe me librat ku janë shënuar hadithet e sakta dhe ato të pasakta. Një kontribut shumë të vyer në këtë fushë kanë dhënë edhe dijetarët e shquar shqiptarë: Muhamed Nasirudin Albani, Abdulkadir Arnauti dhe Shuaib Arnauti, të cilët u kanë lënë botës islame mbi 500 vëllime libra, ku kanë treguar dhe klasifikuar hadithet e sakta nga ato të pasakta.

Muslimani duhet të jetë i kujdesshëm, që të mos përdorë hadithe të dobëta dhe të trilluara, sepse nëpërmjet tyre mund të kuptojë gabim shumë çështje të fesë. Sa herë që dëgjon një hadith që nuk e di, le të pyesë dikë më të dijshtëm për t'u siguruar.

Enes ibn Maliku, njëri prej sahabëve të nderuar thoshte: "Unë hezitohj t'ju tregoj juve shumë hadithe, sepse i Dërguari i Allahut ka thënë: *"Kush tregon me qëllim gënjeshtra në emrin tim, le ta përgatisë vetë vendin e Tij në zjarr."* Buhariu dhe Muslimi.

Duke u bazuar në thënien e Enesit dhe hadithin e Pejgamberit (alejhissalatu ues-selam), dijetarët shpjegojnë, se çdo njeri që neglizhon në çështjen e haditheve dhe nuk u jep rëndësi atyre, nëse janë të sakta apo të dobëta, ai është përgjegjës për atë gjë. Kjo është argumentuar edhe me një hadith tjetër ku Profeti (alejhissalatu ues-selam) thotë: *"Njeriu mjafton që të qubet gënjeshtrar, nëse ai tregon gjithçka që dëgjon."* Muslimi.

Këtu mund të përmendim edhe përhapjen e këtyre haditheve në libra të ndryshëm. Vetëm në literaturën islame shqipe qarkullojnë mbi 4,000 hadithe të dobëta dhe të trilluara. Njerëzit nuk dinë

t'i dallojnë këto hadithe, sepse ato nuk janë të klasifikuara. Rreziku i tyre është i madh, sepse njeriu lexon dhe ndërton shumë çështje të fesë duke u argumentuar me hadithe të pavërteta. Shumë rryma fetare dhe sekte të devijuara, si dhe risi (bidate) të ndryshme kanë lindur dhe kanë lulëzuar pikërisht, se iu janë mbështetur këtyre haditheve të dobëta e të trilluara. Allahu e ka ruajtur fenë e Tij dhe hadithet e sakta, prandaj edhe kërkohet prej nesh që të pyesim e të informohemi rreth haditheve të pasakta e të trilluara e të mjaftohemi veç me hadithet e sakta, mbi të cilat është ndërtuar Feja Islame. Për këtë arsye redaksia e kësaj gazete ka vendosur që në numrat e ardhshëm të përmenden hadithe të dobëta në literaturën islame shqipe për të hequr sado pak përgjegjësinë fetare, që bie mbi ne në këtë drejtim, si dhe të paralajmërojmë për rrezikun e tyre.

## Loja e rrezikshme me LGBT-në

Nga Enklid PELARI

Në këtë artikull nuk synojmë të flasim për këtë komunitet pa komunitet, por të analizojmë precedentët e rrezikshme që krijon promovimi këtij kazusi në shoqëri. Para disa ditësh të gjithë si shoqëri u tronditëm nga rastet e njëpasnjëshme të pedofilisë. Ajo që vlen të përmendet është fakti se disa sociologë të nderuar tekta po trajtonin fenomenin, si pa dashur dolën në mbrojtje të pedofilëve, duke e konsideruar atë si një *sëmundje të lindur apo të përfutur gjatë jetës* dhe që personat në fjalë e kanë nevojë biologjike kryerjen e marrëdhënieve me të mitur.

Ne fakt ata kanë të drejte në një pikë, sepse logjika psiko-sociologjike i trajton të gjitha sëmundjet seksuale si identitare, pra Pedofilinë, Homoseksualitetin, Zoofilinë, Nekrofilinë etj. Në këtë kontekst logjika të çon përballë faktit, se të gjitha këto sëmundje qëndrojnë të binjakëzuara dhe nëse ligji apo shoqëria do të favorizojë njërin prej tyre, atëherë së paku i ka hapur ose duhet t'ia hapë derën të gjitha të tjerave. Pra si pedofilët, si zoofilët, si homoseksualët etj duhet të trajtohen si të sëmurë, që duhen mbajtur "afër" nga shoqëria dhe jo si kriminelë që duhen "izoluara". Prandaj logjika e thjeshtë të çon përpara dy gjykimeve, ose të nxjerrim nga burgu të gjithë pedofilët, ose t'i fusim në burg të gjithë me pedofilë, me homoseksualë, me zoofilë dhe çfarëdo lloj sëmundje që ka lidhje me marrëdhëniet seksuale. Në të kundërt do të jemi inkohorentë përballë disiplinave shkencore. Pjesa tjetër ka të bëjë me vetë komunitetin e LGBT-së. Të gjithë ne kur dëgjojmë "ankesat" dhe peripecitë e këtij komuniteti na bën të ndjehemi pak në faj që jemi kaq "harbutë" me ta. Mirëpo dëshmitë empirike qoftë në Shqipëri apo gjatë na dëshmojnë të kundërtën. Para disa kohësh tek e perditsshmja MAPO u zhvillua një debat midis një gazetari të nderuar E.D. dhe aktivistit kryesor, që i vjen në

mbrojtje kazusit LGBT Kristi Pinderi. Ky i fundit si një njeri që qahet gjithë ditën për diskriminim që i bëhet këtij komuniteti, nuk ngurroi të cenojë privatësinë e gazetarit E.D., duke i përmendur atij disa lapsuse të bashkeshortës në publik. Po i njejt person, i cili ankohet për presion, nuk ngurroi të bëjë presion publik para disa ditësh, duke thënë se kushdo që do të ofendojë LGBT-në do të përfundojë në burg. Përveç se kjo praktikë cenon lirinë e shprehjes, po ashtu i jep këtij komuniteti një privilegj, që nuk e gëzon as kryeministri i vendit. Gjithsesi, këto fakte hedhin dritë ndaj fenomenit të evidentuar tashmë në mbarë globin, ky komunitet përveç antivlerave që percjell, mbart mbi supë një agresivitet dhe arrogancë të pakontestueshme dhe pajisja e tyre me arsenale ligjore dhe ekzekutive është një atentat dhe precedent i rrezikshëm për mbarë shoqërinë.

Pjesa e fundit, por jo më pak e rëndësishme ka të bëjë me cenimin e autonomisë kombëtare. Në fakt me autonomi nuk nënkuptojmë vetëm mos-cenimin e territoreve gjeografike dhe vendim-marrjes politike, por nënkuptojmë po ashtu edhe integritetin e vlerave, zakoneve dhe traditave të mira të një vendi. Trupi diplomatik i akredituar në Tiranë, që për hir të së vërtetës po e trumbeton me të madhe këtë kazus, kur ka mbërritur këtu e ka pranuar shoqërinë shqiptare me të gjitha vlerat morale dhe religjioze që mbart. Nëse ambasadorët e akredituar do të hidhnin një sy ndaj censusit të fundit do të konstatojnë, se mbi 76.5% e njerëzve të deklaruar i përkasin një religjioni të caktuar. Pra në dominancë organike ky vend është religjioz dhe të promovosh këtu një imoralitet të tillë të paktën ke cenuar integritetin religjioz, ose ke bërë me apo pa dashje një gabim diplomatik, i cili në një vend normal do të shoqërohej me një notë proteste nga qeveria. Sepse siç thote edhe kolegu Artan Lame: "Është gjë e madhe të bëhen bashkë tre ambasadorë dhe kur kjo gjë bën vaki,

medoemos një gjë e madhe duhet të dalë prej këtij takimi. Me takime ambasadorësh janë vendosur fate kombesh, janë bërë e janë ç'bërë shtete e mbretëria...".

Prandaj nisur nga kjo ne si shoqëri civile i bëjmë thirrje ambasadave, avokatit të popullit, organizatave që ushqehen me këtë punë, por edhe kujtdo tjetër që qëndron

prapa, para, poshtë apo lart këtij kazusi që të reflektojë mbi realitetin e mjeruar shqiptar, i cili është plagosur nga konfliktet civile, trazira politike, skamje e varfëri, dhe mos të krijojë hendekun *-tashmë të krijuar-* midis vuajtjeve sociale dhe luksit të kazuseve fantazëm, sepse kjo do të jetë një kosto e shtuar për shoqërinë.

## Përurohet nisja e punimeve për Xhaminë e Madhe të Tiranës



Pas përuimit të punimeve për Xhaminë e Madhe të Prishtinës tashmë bëhet realitet edhe përuimi i punimeve për Xhaminë e Madhe të Tiranës. Me një ceremoni të posaçme në vendin e quajtur Namazgjaja pranë rrugës së Elbasanit në Tiranë më 20 prill 2013 në një atmosferë festive është bërë e ditur publikisht përuimi i punimeve. Në këtë ceremoni merrnin pjesë besimtarë dhe dashamirës të Islamit, ku ishin ftuar edhe autoritetet e larta shtetërore. Pasi u njoftua zyrtarisht, se më në fund ishin mbyllur të gjitha bisedimet për zgjidhjen më së fundi të problemit të Xhamisë së Madhe fjalën e morën për të përhëndetur autoritetet. Në këtë tubim përhëndeti kryeministri dr. Sali Berisha, i cili shprehu kënaqësinë për realizimin më në fund të projektit të

Xhamisë së Madhe. Po ashtu përhëndeti edhe z. Lulzim Basha, kryetari i Bashkisë së Tiranës. Në mbarim të këtyre përhëndetjeve kryeministri Berisha, kryetari Basha, si dhe kryetari i KMSH-së Selim Muça firmosën një dokument themelues të punimeve për Xhaminë e Madhe. Xhamia e Madhe do të ketë një sipërfaqe prej gati 7,000 metra katrorë dhe do të jetë e përbërë prej disa nivelesh. Po ashtu pranë këtij kompleksi do të ngrihet edhe godina e re KMSH-së. Projekti fitues ka qenë ai i një studioje projektimi të mirënjohur turke HASSA me inxhinierin arkitekt Muharrem Hilmi Shenalp. Për financimin e Xhamisë së Madhe janë vënë në dispozicion nga KMSH edhe numrat e llogarive përkatëse për të gjithë ata që duan të kontribuojnë për këtë xhami.

"O burra! Sa të drejta keni ju mbi gratë, po aq të drejta kanë edhe ato mbi ju, prandaj jeni të detyruar të respektoni të drejtat e njëri tjetrit". Hafiz Dalliu

## Shoqëri / Martesa në këndvështrimin Islam

Nga Xhemal Balla

Në Kuranin e madhërishtëm, gruaja përcaktohet si një entitet i pavarur dhe sipas kësaj, një qenie plotësisht përgjegjëse njerëzore. Në kodin islam, femrës i drejtohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, pa ndërmjetësinë e meshkujve. Asaj, sapo të arrijë pjekurinë, i njihen aftësitë dhe përgjegjësitë e plota për veten e saj. Pranimi i fesë islame është një çështje krejtësisht personale. Në Kuran thuhet: "Çdo njeri është peng i veprës së vet". Pra, kuptohet qartë se edhe kur bëhet fjalë për femrën, ajo përgjigjet direkt për detyrimet, angazhimet dhe veprat e saj.

Femra, ashtu si mashkulli, ka mundësinë dhe nxitjen nga islami për të marrë pjesë në çdo aspekt të jetës e deri në zgjedhjen e partnerit të saj si bashkëshort, për ndërtimin e familjes me martesë ligjore. Fillimisht shfaqet me pëlqimin ndërpersonal, që karakterizohet nga faktorët më të rëndësishëm të saj si afërsia, ngjashmëria dhe paraqitja fizike. Puna në grup apo kolektiv të gjerë i bën individët, pa dallim gjinor, më të afërt, më të kuptueshëm, të njohin njëri tjetrin e të bëhen deri dhe miq. Afërsia e komunikimi i sinqertë i bashkon më shumë, duke pëlqyer tek njëri tjetri moralin e bukur dhe aftësitë intelektuale të përbashkëta. Baza e këtyre marrëdhënieve në mes njëri tjetrit, të një djali me një vajzë, është drejtësia, sinqeriteti e mirëkuptimi. Në këto kushte individët motivohen dhe janë në gjendje të ruajnë marrëdhënie të ekuilibruara në mes njëri tjetrit. Në raste të veçantë, në mes djalit dhe vajzës, një njohje e tillë i çon në dëshirimin intim, që shkakton marrëdhënie intensive dhe pasionante, që sjell emocionin e dashurisë. Atëhere secili e kupton tjetrin, shqetësohet për të, pranon përgjegjësinë për ta ndihmuar në çfarëdo mënyre etj., gjë që çon edhe në propozimin për martesë. Këtu kemi të bëjmë me një dashuri të përmbajtur, që ka në mes besnikërinë, respektin, përzemësinë, barazinë dhe aftësinë. Jo vetëm djali, por dhe vajza, mund të propozojë një mashkull për martesë. Lirisht ajo mund të zgjedhë bashkëshortin e saj ose të refuzojë propozimet që nuk i pëlqejnë. Lidhja martesore është një marrëveshje midis dy sekseve, mbi bazën e dashurisë. H.Dalliu shprehet: "Nuk lejohet që të ndalohet gruaja nga martesë e ligjshme". Sipas ligjeve islame femra nuk mund të martohet me mashkullin sipas forcës së zakonit apo të presionit familjar, pa pëlqimin e saj. Në bazë të veçorive fiziologjike e psikologjike të dy kanë të drejta dhe detyrime të barabarta për zgjedhje martesore. Qysh në kohën e profetit Muhammed, paqja dhe bekimi i Zotit qoftë mbi të, femrat dhe meshkujt takoheshin me njëri tjetrin, bisedonin dhe bashkëpunonin në mënyrë intensive. Ky standart sot është akoma më i avancuar, takohen bashkë, bisedojnë, përshëndeten me një gjuhë të ndershme dhe të pastër e me qëllim të mirë. Kur interesimi i mashkullit



apo i femrës përqëndrohet jo vetëm në paraqitjen fizike dhe shprehjen e interesit apo kontrollit social, por edhe në probleme të karakterit, sinqeritetit, bukurisë shpirtërore etj., atëhere kemi të bëjmë me një tregues të dashurisë. Në Kuran thuhet: "I lartësuar është Ai (All-llahu) që i krijoi të gjitha llojet në çift". Nga argumenti kuranor kuptohet se martesë është një nga ligjet e Zotit, që shërben për shtimin e llojit njerëzor, mbi bazën e një morali të shëndoshë, në mbrojtje të nderit dhe të identitetit të secilit. Marrëdhëniet intime në mes të partnerëve të jenë të ligjshme, që të ruajnë tek pasardhësit genin pozitivë. Duke folur lidhur me këtë problem, H. Dalliu shprehet: "Martesa nuk është vetëm qëllim për të prerë ngacmimet e epshit, por edhe për shtimin e njerëzve, që kështu njerëzimi të vazhdojë brez pas brezi deri në ditën e kijametit".

Martesa shërben edhe për disiplinimin e epsheve e pasioneve, por nuk lejon që gruaja të përdoret si plaçkë tregu, për shitje e trafikim, vetëm për kënaqësi të çastit nga njerëz pa dinjitet e pa moral. Janë të dëmshme veprime të tilla si nga ligjet e Kuranit ashtu edhe të shtetit. Martesa është institucion vetëm familjar, nga ku lindin fëmijë me identitet, të edukuar me ndjenja prindërore. Në Kuran thuhet: "All-llahu krijoi për ju bashkëshortë nga lloji juaj dhe prej tyre fëmijë...". Në një ajet tjetër thuhet: "dhe martoni të pamartuarit". Pra, tërheq vëmëndjen duke premtuar se martesë është një nga mënyrat për t'u pasuruar si nga ana materiale ashtu edhe shpirtërore.

Kushtetuta islame me ligjet e saj nxit martesën si të domosdoshme, si për djalin dhe për vajzën, për rolin e rëndësishëm të tyre në shoqëri. Në të kontrollohen epshet e pasionet, kënaqen dëshirat në mes të bashkëshortëve pa krijuar konflikte. Në Kuran thuhet: "Dhe nga argumentat e madhërisë së tij është, se për të mirën tuaj, krijoi nga lloji juaj gratë, në mënyrë që të gjeni prehje tek ato dhe në mes jush krijoi dashuri dhe mëshirë".

Konsiderohet padrejtësi ndaj femrës izolimi i saj nga jeta e përditshme. Statusi

i të drejtave të saj ka bazë Hyjnore në Kuranin fisnik dhe mesazhin e profetit Muhammed, të cilët, sa do që historia i ka shtrembëruar, ato mbeten për besimtarët detyra humane për t'u respektuar, sepse pa pjesëmarrjen e tyre, mendimi dhe progresi i shoqërisë nuk mund të arrihet. Në bashkëveprimet e komunikimet në mes të njëri tjetrit duhet të mbizotërojë sinqeriteti e respekti reciprok. Profeti Muhammed urdhëron e thotë: "Tri gjëra përbëjnë lumturinë: e para, gruaja e mirë, të cilën kur e shikon, të pëlqen dhe kur nuk je prezent e ruan nderin e saj dhe pasurinë tënde; e dyta: banesa funksionale; e treta: mjeti i udhëtimit".

Një familje e konsoliduar dhe e harmonizuar sjell efekte pozitive në shoqëri, jo vetëm në marrëdhëniet, por edhe në respekt e dashuri me njëri tjetrin. Martesa në islam konsiderohet si një nga prioritetet madhore të cilën Zoti e krijoi për shtimin e llojit njerëzor. Martesa që nuk është e aftë të plotësojë detyrimet bashkëshortore nga njëri prej partnerëve, është e destinuar të prishet. Ka familje që janë në krizë për shkak të lidhjeve të ulta jashtëmartesore, ka tendenca për degradimin e gruas, gjoja në emër të së resë, emancipimit pa kufi të saj, lirisë së saj pa bashkëshortë. Gruaja çdo ditë e më shumë po nxjerr në shesh sekretet e intimitetit të saj dhe është bërë objekt i syrit mashkullor. Gruaja në islam gjen vendin dhe identitetin e saj të plotë, ku burri i saj gjen prehje e qetësi, sepse është dashuria e zemrës së tij dhe nëna e fëmijëve të tij. Ajo ruan për të sekretet e intimitetit të saj. Profeti Muhammed, paqja e bekimi i Zotit qoftë mbi të, ka thënë: "Kush martohet me një grua për pasurinë e saj, All-llahu nuk do t'i japë gjë tjetër veç varfërisë; kush martohet me një grua për pozitën e saj të lartë, All-llahu nuk do t'i japë gjë tjetër veç përcmimit dhe kush martohet me një grua për të mbrojtur shikimin, për të ruajtur nderin dhe për të mbrojtur lidhjet familjare, All-llahu do ta bekojë këtë çift me njëri tjetrin".

Gruaja që mbart cilësi e virtyte islame është e dashur vetëm për burrin e saj, e cila i a shpalos të gjitha ndjenjat e dëshirat atij,

duke u bërë mbrojtëse e moralit të saj. Një martesë e tillë është e qëndrueshme dhe ruan harmoninë e jetës bashkëshortore. Garancia e marrë me aktin e martesës, në prani të dëshmitarëve në zyrtat e gjendjes civile, ligjërohet me dokument që i vërteton ata burrë e grua. Është e kundraligjeshme martesë pa kurorëzim, apo me kontratë të përkohshme. Martesa përbën aktin më të rëndësishëm në jetën e çiftit bashkëshortor. Ajo përcakton stadin e ri të tyre me të cilin do të përjetojnë emocionet e reja, mirësi e dashuri të sinqertë dhe një të ardhme të lumtur. Lumturia më e madhe e çiftit bashkëshortor, ndodh kur kurorëzohet me frytin e tyre, lindja e fëmijës nga gjaku i tyre.

Sot problemet ekonomike e sociale e kanë kthyer konceptin e martesës, duke u prirur më shumë nga ana materiale se sa ajo shpirtërore. Djali apo vajza shohin më shumë pasurinë e njëri tjetrit, për të përfutuar secili në kurriz të tjetrit. Kjo shoqërohet edhe me idenë e mosbesimit të secilit partner, që mund të sjellë zhgënjime deri në prishjen e saj. Profeti Muhammed, paqja e bekimi i Zotit qoftë mbi të, urdhëron e thotë: "Martohuni që të shtoheni". Atëhere me aktin e martesës dhe me lindjen e fëmijës, krijohen marrëdhënie të reja nënë-fëmijë. Veçanërisht nënës i është caktuar roli rritës e ushqyes, edukues e përkujdesës, që merr kuptim vetëm atëhere kur ka edhe kontributin e bashkëshortit të saj. Ledhatimi i ëmbël, buzëqeshja, përqafimi janë shprehjet më të bukura që merr fëmija nga të dy prindërit. Fëmija lind me natyrë të pastër dhe fillimisht nëna do t'i japë ushqimin e parë shpirtëror, të besimit apo mosbesimit. Të dy prindërit do të jenë baza e formimit të karakterit të fëmijës. Vlerat e edukatës së tyre do të duken kur ata të kenë pajisur edhe fëmijët e vet me një edukatë të shëndoshë, që të kuptojnë përgjegjësitë përpara Zotit të madhërishtëm. Fëmijët nuk duhet të harrojnë asnjëherë edhe mbasi arrijnë moshën madhore, se Zoti është ai që ka vendosur dashuri, përkujdesje e dhembshuri në zemrat e prindërve të tyre. Në Kuran thuhet: "All-llahu u ka nxjerrë nga mitrat e nënave tuaja duke mos ditur asgjë. Ai ju dha edhe shikimin, dëgjimin dhe zemrën që të mund të falenderoni". Për këtë është e nevojshme të merret në konsideratë edhe mendimi i prindërve nga fëmijët e tyre, në momentin që vendosin për zgjedhjen e partnerit për martesë, si një eveniment me rëndësi në jetën e tyre. Kjo e drejtë u është dhënë nga Zoti i plotëfuqishëm, që përbën një besim, që duhet të mbushë zemrën e secilit, si një ideal të vërtetë e të drejtë, i cili jep fryte të shkëlqyer në të ardhmen.

Bashkëshortët prindër si dhe fëmijët e tyre duhet të mbajnë premtimet që i kanë dhënë njëri tjetrit, siç thotë Zoti në Kuran: "...kush përmbush amanetin e vet, është besnik dhe s'ka dyshim që ruhet nga mëkati. All-llahu i do ata që ruhen".



## DYQANI I MISHIT "HALLALL"

- ✓ Tregton mish vici, qengji, qofte dhe sallameri të firmës "Meka", me shumicë dhe pakicë.
- ✓ Ofron qengja për kurbanë dhe akika.

Adresa: Rr. "Bedri Cullhaj", tek Goni, pranë Xhamisë së Kombinatit  
Tel: 04 2350569; Cel: 0672050070  
Email: agronxhepa@hotmail.com

## DYQANI I MISHIT "HALLALL", Kombinat



## PRODUKTE NATYRALE

Produkte bimore të cilësisë më të mirë nga vendet e Lindjes!



*Jeni të mirëpritur!*

*Në dyqanin tonë do të gjeni:*

- Produkte të firmës "Phenomenal"; vaj të farës së zezë (Habbe Seuda) etj.
- Vajra bimore të firmës "Tact" (mbi 70 lloje bimësh)
- Mjaltë nga lulja e farës së zezë, mjaltë me polen, mjaltë me qumësht blete, mjaltë sidri, etj.
- Hurma arabie të freskëta dhe ujë zemzemi
- Kremra të ndryshëm të firmës "Orchid" dhe shampo
- Vajra el -Bedil, përzierje vajore kundër rënies së flokut
- Parfume vajore (3 ml) me aroma të llojllojshme
- Parfume me mbushje të markave më të njohura europiane
- Misvak dhe pastë dhëmbësh me misvak
- Këna bimore 100% natyrale për flokë dhe për duar.
- Kohël bimor për sytë etj.

**Adresa: Rr. e Kavajës,  
rrugica përballë xhamisë  
"Dine Hoxha", Tiranë**

**Cel: 0672812607 / 0672821589**

# A.M.B.C

ALBANIAN MUSLIM BUSINESS CENTRE



[www.lidhjatregtareve.com](http://www.lidhjatregtareve.com)